



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 37
Prishtinë, më 2. 06. 2009, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush dhe Shpresa Murati.

Mungoi: Drita Maliqi – mos pjesëmarrjen e saj e arsyetoi.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Rrezarta Ahmeti – KDI, Elita Vokshi – OSBE, Driton Selmani – KDI, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit dhe Petrit Hysaj – OSBE.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Visar Krasniqi.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë:

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Miratimi i rekomandimeve të Planit – Sfidat e raportit të progresit,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit të Shoqërisë Civile për nismën e ndryshimit dhe të plotësimit të Ligjit për vetëqeverisjen lokale,
4. Shqyrtimi i ankesave,
5. Të Ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

1 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari - Konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Miratimi i rekomandimeve të Planit – Sfidat e raportit të progresit

Kryetari – I përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi për shqyrtimin e obligimeve të dala nga Plani – Sfidat e raportit të progresit. Propozoi që Komisioni të organizojë një takim pune, në mënyrë që raporti të shqyrtohet në hollësi dhe të nxjerrën rekomandimet përkatëse.

Pasi , nuk pati vërejtje lidhur me këtë pikë, Komisioni vendosi që të martën, më 9. 6. 2009, në orën 11:00, të organizojë takim pune në mënyrë që të nxirren rekomandimet e dala nga Plani –i veprimit – Sfidat e raportit të progresit.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit të Shoqërisë Civile për nismën e ndryshimit dhe të plotësimit të Ligjit për vetëqeverisjen lokale

Kryetari - E njoftoi Komisionin me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shqyrtimin e kërkesës se Grupit të Shoqërisë Civile për plotësimin dhe për ndryshimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale. Ai lejoi debat dhe ftojë anëtarët që të merrnin fjalën.

Sanije Alijaj – Tha se këtu kemi të bëjmë me dy çështje: E para se shoqëria civile na drejtohet me nënshkrime për ta bërë një ligj më funksional, e dyta është se ky ligj bën pjesë në kuadër të ligjeve që dalin nga Pakoja e Ahtisarit. Duke u ndërlidhur me këtë pikë tha : Se kohë më parë ishte organizuar takim me përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane dhe me përfaqësuesit e EULEKS-it, të cilët shprehen rezervë për këtë ligj dhe konstatuan se bënë pjesë në ligjet që dalin nga Pakoja e Ahtisarit. Prandaj, i propozoj komisionit të organizohet debat lidhur me këtë ligj, në mënyrë që të çohet në vend vullneti i atyre që i drejtohen Komisionit.

Ibrahim Makolli – shprehu mendimin se nisma e shoqërisë civile për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për vetëqeverisjen lokale e ka bazën ligjore, dhe mbështetet në nenin 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prandaj ishte i mendimit se ky ligj bie në fushëveprimin e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media. Ndërsa lidhur me ligjin tha se është në kundërshtim me Kushtetutën dhe se ky ligj bën pjesë në kuadër të kompetencave të Komisionit për Pushtetin Lokal dhe Media. Shtoi se Ligji i pushtetit lokal është në kundërshtim me Kushtetutën. Dhe për këtë arsye Komisioni për Legjislacion do të duhej të jap mendimin se a ka bazë kushtetuese.

Pas një debati konstruktiv që u zhvillua lidhur me këtë pikë, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni vendosi t'ia procedoj për shqyrtim të mëtejme Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, pasi kjo çështje nuk i përket fushëveprimet të tij.

4. Shqyrtimi i ankesave

Nerxhivane Dauti – në cilësi të raportueses tha - se e ka shqyrtuar me kujdes ankesën për rishqyrtimin e çështjes së licencimit të studenteve të diplomuar në Fakultetin e Shkencave Matematiko – Natyrore, Drejtimi Biologji Aplikative dhe u sugjeroi që serish të kërkojnë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë përsheptimin e zgjidhjes së çështjes së licencimit. Komisioni u pajtua me sugjerimet dhe i miratoi.

Ndërsa lidhur me peticionin e parashtruar nga banorët e Llabjanit dhe të Pasjakut, të ndihmuar nga “Lëvizja Vetëvendosje” ku kundërshtohet decentralizimi, tha se dokumenti Pakos Ahtisarit është bazë e statusit dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kundër decentralizimit të paraparë me Pakon e Ahtisarit, propozoi që Komisioni të nxjerrë këtë prandaj kërkesa për shqyrtimin e tij nuk bie në fushëveprimin e Komisionit për Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione. Komisioni u pajtua me sugjerimet dhe i miratoi.

5 Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk u zhvillua debat.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 30.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri